

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6757
E hënë, 14 nëntor 2022
çmimi 0.40

Nderohen ushtarët e Mbretërisë së Bashkuar që humbën jetën në Kosovë




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJASHTË TË VRARË DHE DHJETËRA TË PLAGOSUR NË NJË SULM NË TURQI

FAQE 4



Të paktën gjashtë persona u vranë dhe mbi 81 u lënduan pas një shpërthimi që ndodhi të dielën në Stamboll. Presidenti i Turqisë,

Rexhep Tajip Erdogan, tha se ky mund të jetë sulm "terrorist" dhe shtoi se keqbërësit do të përballen me drejtësinë. Shpërthimi i 13

nëntorit që, sipas Erdoganit, u shkaktua nga një bombë, ndodhi në një rrugë të frekuentuar të Stambollit

AKTUALE



DEMOKRATËT MBAJNË KONTROLLIN E SENATIT

F. 2

AMBASADORI FRANCEZ VIZITON MEMORIALIN "ADEM JASHARI": S'ËSHTË KOHA TË RRITE TENSIONET

F. 3

NË PARIS, KURTI ME AFD-NË DISKUTON PËR ÇËSHTJEN ENERGJETIKE DHE MJEDISORE

F. 6

EKONOMI



"SUPER-TAKSË" PËR FERMERËT SHQIPTARË QË LËNË TOKËN DJERRË

F. 7

MINISTRAT E G20-S, FOND MILIARDËSH PËR PANDEMINË

F. 8

SPORT



DERBI I TAKON GJILANIT, FITOJNË EDHE DRITA E BALLKANI

F. 10

PROPOZIMI I RI PËR LIBERALIZIMIN HYN NË FUQI JO MË VONË SE NË DHJETOR 2023

FAQE 5

NË MITROVICË TË VERIUT SHFAQEN GRAFITE PËR "REZISTENCË" NDAJ VENDIMIT PËR TARGAT

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Demokratët mbajnë kontrollin e Senatit

WASHINGTON, 13 NËNTOR - Demokratët do ta mbajnë kontrollin e Senatit amerikan pas fitores në shtetin e Nevadës.

Senatorja Chatherine Cortez Masto ka mposhtur në Nevada kundërkandidatin e saj republikan, Adam Laxalt, i cili ishte mbështetur nga ish-presidenti Donald Trump.

Këto janë rezultatet më të mira të Partisë Demokratike në zgjedhjet e mesmandatit në 20 vjetët e fundit.

Presidenti amerikan Joe Biden tha se është jashtëzakonisht i kënaqur me rezultatin, duke shtuar se është koha për republikanët të vendosin "se kush janë".

Lideri i demokratëve në Senat, Chuck Schumer, tha se rezultati tregoi se populli amerikan ka refuzuar atë që ai e quajti "retorikë të dhunshme" të Partisë Republikane.

Vetëm në Xhorxhia do të zhvillohet raundi i balotazhit në dhjetor. Në rast se dy partitë do të kenë numër të njëjtë të ulëseve në Senat, atëherë nënpresidentja amerikane, Kamala Harris, do ta ketë votën që do të vendosë.

Republikanët mund ta marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve teksa ende po numërohen votat për zgjedhjet e mesmandatit që u mbajtën të martën.

Nëse republikanët fitojnë në

Dhomën e Përfaqësuesve, ata mund ta pengojnë agjendën e Bidenit. "Nuk jam i befashuar nga rezultati. Jam jashtëzakonisht i kënaqur. Mendoj se rezultati zgjedhor reflekton kualitetin e kandidatëve tanë", deklaroi Bideni në Kamboxhia.

Schumer tha se shteti ka "treguar se ne besojmë në demokracinë tonë dhe se rrënjët janë të forta dhe do t'ia dalim për aq kohë sa ne luftojmë për të".

Cortez Masto ishte në garë të ngushtë me Adam Laxalt.

Ish-presidenti amerikan, Donald Trump, që ka insistuar në mënyrë të pabazuar se ka fituar zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, ka bërë pretendime të ngjashme edhe për



zgjedhjet e mesmandatit.

Trumpi pritet të njoftojë se do të garojë sërish për president më 2024.

Ky rezultat është një goditje e madhe për republikanët, që po prisnin të korrnin fitore ndaj

partisë së presidentit Biden. Përderisa republikanët vazhdojnë të jenë favoritë për ta marrë kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve, demokratët e Bidenit kanë dalë më mirë në zgjedhje sesa pritej.

Netanyahu mandatohet për formimin e qeverisë së re izraelite



JERUSALEM, 13 NËNTOR - Ish-kyeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka siguruar mandatin për ta formuar qeverinë e re, duke hapur rrugë rikthimit të tij në udhëheqjen e shtetit.

Ekzekutivi i ri pritet të jetë administrata më e djathtë që Izraeli ka pasur ndonjëherë.

Pas një krize të paprecedentë politike në Izrael, shtet ku në më pak se katër vjet janë mbajtur pesë palë zgjedhje, votimet e 1 nëntorit i dhanë Netanyahu dhe aleancës së tij të ekstremit të djathtë një shumicë të qartë në Parlamentin prej 120 ulësesh. "Kam vendosur që t'ju jap ju, Benjamin Netanyahu, detyrën për formimin e qeverisë", tha presidenti izraelit Isaac Herzog gjatë ceremonisë të mbajtur në

Jerusalem më 13 nëntor.

Duke pranuar mandatin, Netanyahu, 73 vjeç, u zotua se do të shërbejë për të gjithë izraelitët, "për ata që na votuan dhe ata që s'na votuan. Kjo është përgjegjësia ime".

Netanyahu, që po përballet në gjyq me akuza për korrupsion, tani do të ketë 28 ditë për ta formuar koalicionin qeverisës me aleatët e tij - dy parti ultra-ortodokse hebreje dhe një aleancë në rritje e ekstremit të djathtë e quajtur Zionizmi Fetar. Herzog theksoi se është i vetëdijshëm që Netanyahu po përballet me drejtësinë. "E di faktin që ka procedura ligjore që po vazhdojnë ndaj zotit Netanyahu në Gjykatën e Qarkut të Jerusalemit", tha ai. Por, ai tha se precedentët e fundit e kanë bërë

të qartë që Netanyahu mund të shërbejë si kryeministër dhe të përballet me organet e drejtësisë. Netanyahu pritet që të njoftojë së shpejti për formimin e koalicionit qeverisës.

Itamar Ben-Gvir dhe Bezalel Smotrich, bashkudhëheqës të bllokut të Zionizmit Fetar, publikisht kanë kërkuar të udhëheqin dy ministri kyçe, atë të Sigurisë Publike dhe Mbrojtjes. Kjo kërkesë vjen në kohën e dhunës midis Izraelit dhe palestinezëve.

Gjatë mandateve të kaluara të Netanyahu në krye të qeverisë izraelite ka kolapsuar procesi i bisedimeve të paqes në Lindjen e Mesme dhe janë zgjeruar ndërtimet e vendbanimeve izraelite në Bregun e pushtuar Perëndimor.

Rimarrja e Hersonit, "historike" për Ukrainën, por Kievi përballet me rreziqe të reja

KIEV, 13 NËNTOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka përshkruar rikthimin e forcave të tij në qytetin juglindor të Hersonit si "ditë historike", por zyrtarët kanë paralajmëruar se do të ketë përpjekje të vështira në të ardhmen, edhe pse liderët e instaluar nga Rusia më në lindje të Ukrainës kanë sinjalizuar për një tërheqje të re të forcave ruse. "Sot është ditë historike. Ne po kthehemi në Herson", tha Zelensky gjatë një adresimi në orët e vona të 12 nëntorit. Ai shtoi se "mbrojtësit tanë janë në periferi të qytetit", ndërkaq "njësitë speciale veçse janë në qytet". "Banorët e Hersonit kanë qenë në pritje për këtë", tha ai. "Ata kurrë nuk e braktisën

Ukrainën. Shpresa për Ukrainën është gjithmonë e justifikuar dhe Ukraina do të marrë atë që i takon".

Zelensky i përshkroi si "ferr" betejat në rajonin lindor ukrainas të Donjeckut.

Atje, siç sugjerojnë raportimet, forcat ruse dhe ato pro-Moskës thuhet se po vazhdojnë luftimet e ashpra për t'i mbajtur territoret nën kontroll.

Shtabi i Përgjithshëm i Ukrainës tha se forcat e tij kanë neutralizuar afër 650 trupa ruse më 12 nëntor, por ky pretendim nuk mund të konfirmohet në mënyrë të pavarur. Megjithatë, ky pretendim lë të kuptohet se Kievi po vazhdon me vetëbesim kundëroffensivën për ta marrë

territorin e pushtuar nga forcat ruse.

Njoftimi i zyrtarëve rusë, se forcat e tyre po tërhiqen nga Dnjepër, lumë që gjendet në rajonin e Hersonit, u pa si sukses i madh i kundëroffensivës ukrainase në jug të vendit.

Shtetet e Bashkuara e kanë cilësuar tërheqjen e Rusisë nga Hersoni si "fitore të jashtëzakonshme" për Ukrainën. Sekretari britanik i Mbrojtjes, Ben Wallace, parashikoi se "dështimi strategjik" i Moskës në Herson do të ndjellë mëdyshje në mesin e publikut rus lidhur me luftën në Ukrainë.

Autoritetet ukrainase thanë se kanë "stabilizuar" zonën, teksa po përballet me detyrën e vështirë



në Herson për t'i çaktivizuar bombat dhe për të siguruar ujë dhe rrymë dhe nevojat bazë për qytetarët. "Para se të largoheshin nga Hersoni, pushtuesit shkatërruan të gjithë infrastrukturën kritike: komunikimet, ujin, ngrohjen dhe

rrymën", tha Zelensky. Një tjetër shenjë e presionit ukrainas ndaj forcave pushtuese është se administrata e instaluar nga Rusia në qarkun Hahovka, në lindje të Novaja Herson, tha se po largon stafin "në një territor më të sigurt".

Nderohen ushtarët e Mbretërisë së Bashkuar që humbën jetën në Kosovë

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, bëri homazhe dhe vendosi lule te memoriali kushtuar ushtarëve të Mbretërisë së Bashkuar, të cilët humbën jetën gjatë

shërbimit të tyre në kuadër të forcave paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë. Në ceremoninë e Ditës së Përkujtimit të Mbretërisë së Bashkuar, të organizuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë,

krahas kryetarit Glauk Konjufca dhe ambasadorit Nicholas Abbott, morën pjesë dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve shtetërore, drejtues të FSK-së, KFOR-it e të misionëve të tjera në Kosovë.



Në Mitrovicë të Veriut shfaqen grafite për "rezistencë" ndaj vendimit për targat



MITROVICË, 13 NËNTOR - Në Mitrovicën e Veriut të dielën u shfaq një mesazh i ri nga e ashtuquajtura "Brigada Veri", përmes të cilit u bë thirrje për "rezistencë" nga 21 nëntori, kur Qeveria e Kosovës ka thënë se do ta nisë gjëritjen e shoferëve që kanë targa të lëshuara nga Serbia. "Që nga 21 nëntori është detyrë e të gjithëve të rezistojnë në çdo hap! Brigada Veri", thuhet në grafitet që janë shfaqur në Mitrovicë të Veriut.

Grafitet me ngjyrë të kuqe, të kaltër dhe të bardhë u panë në qendër të Mitrovicës së Veriut - komunë e banuar me shumicë serbe që gjendet në veri të

Kosovës - pranë monumentit të Car Lllazarit, sheshit kryesor të qytetit dhe në rrugën Krajl Petra. Fotografitë e këtyre grafiteve janë publikuar edhe në faqen në "Instagram" të titulluar "Jo dorëzim, KM mbetet".

Kjo nuk është hera e parë që në Mitrovicë të Veriut shfaqen grafite. Në gusht, në rrugët e këtij qyteti, u shfaq grafiti me mbishkrimin: "Mos u shqetësoni, ne jemi këtu. Po ju presim, Brigada e Veriut".

Dallimi mes grafiteve të gushtit dhe të 13 nëntorit është se në mesazhe është nënshkruar "Brigada Veri" dhe jo siç ishte më herët "Brigada e Veriut".

Qeveria e Kosovës nga 1 nëntori ka nisur zbatimin e planit të saj prej tri fazash për reregjistrimin e makinave që kanë targa të lëshuara nga Serbia. Kryesisht bëhet fjalë për targat KM, akronim serb për Mitrovicë e Kosovës.

Plani i qeverisë është që të gjitha makinat me targa serbe të konvertohen në targa RKS - Republika e Kosovës deri më 21 prill të vitit 2023.

Faza e parë parasheh lëshimin e qortimeve për drejtuesit e automjeteve me targa serbe. Faza e dytë nis më 21 nëntor dhe parasheh gjorbë prej 150 eurosh për këta shoferë. Faza e tretë

përfshin përdorimin e targave provuese, ndërsaq pas 21 prillit, Qeveria e Kosovës ka thënë se do të lejohen të qarkullojnë vetëm makinat me targa RKS.

Në shenjë pakënaqësie lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës, serbët janë larguar nga institucionet e Kosovës në katër komunat në veri: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Por, pavarësisht prej largimeve të serbëve nga institucionet - nga policia, gjykatat, prokuroria, Kuvendi, qeveria dhe institucionet e tjera - kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi më 7 nëntor se puna e institucioneve

të Kosovës në veri po vazhdon. Kurti tha se ditët e fundit janë shtuar kërcënimet dhe përpjekjet e Serbisë dhe presidentit të saj, Aleksandar Vuçiq, për ta destabilizuar situatën në Kosovë, duke shtuar se kërcënimet ndaj qytetarëve po bëhen "për të mbjellë frikë dhe panik".

Që nga 5 nëntori, kur serbët nisën largimin nga institucionet e Kosovës, në veri nuk shihen policë në rrugë, përveç makinave të patrullimit që herë pas here shihen nëpër qytet.

Besohet se në veri të Kosovës janë afër 10 000 makina me targa serbe të cilat Kosova i konsideron ilegale.


Ambasadori francez viziton memorialin "Adem Jashari": S'është koha të rriten tensionet

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka vizituar Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ai ka thënë se s'është koha t'i lënë tensionet të rriten.

Gueroti ka theksuar se është i prekur nga madhështia e memorialit "Adem Jashari". "Isha dje në memorialin e Adem Jasharit dhe rreth 60 të afërmve që u vranë në vitin 1998. I prekur

thellë nga madhështia e këtij vendi dhe nga gjurmët e dhunës brutale. 25 vjet më vonë, nuk është koha për t'i lënë tensionet të rriten", ka shkruar Gueroti në "Twitter".





Gjashtë të vrarë dhe dhjetëra të plagosur në një sulm në Turqi

Të paktën gjashtë persona u vranë dhe mbi 81 u lënduan pas një shpërthimi që ndodhi të dielën në Stamboll. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, tha se ky mund të jetë sulm "terrorist" dhe shtoi se keqbërësit do të përballen me drejtësinë. Shpërthimi i 13 nëntorit që, sipas Erdoganit, u shkaktua nga një bombë, ndodhi në një rrugë të frekuentuar të Stambollit

STAMBOLL, 13 NËNTOR - Të paktën gjashtë persona janë vrarë dhe 81 janë lënduar nga shpërthimi në një zonë të frekuentuar në qendër të Stambollit, thanë autoritetet turke më 13 nëntor. Sulmi ndodhi në orën 16:20, sipas kohës lokale, në një rrugë në zonën e Sheshit Taksim, tha guvernatori i Stambollit, Ali Yerlikaya. Zëvendëspresidenti i Turqisë, Fuat Oktay, tha se besohet se shpërthimi është sulm terrorist, i kryer nga një grua. Ndërkaq, presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, tha se keqbërësit do të ndëshkohen. Duke folur në një konferencë për medie në Stamboll, Erdogani e dënoi sulmin "e poshtër" dhe tha se këtij sulmi po i "vjen era terror". "Mund të jem gabim nëse e them se jam i sigurt se ky është terror por, sipas shenjave të para..., ka një erë terrori në këtë ngjarje", tha Erdogani në konferencën për medie. "Përpyekja për ta sunduar Turqinë dhe popullin e Turqisë

përmes terrorizmit nuk do të jetë e mundur të arrihet as sot, as nesër", shtoi ai. Sipas liderit turk, katër persona vdiqën në vendin e ngjarjes dhe dy janë të shtrirë në spital. Në vendin ku ndodhi shpërthimi ka dyqane dhe restorante dhe në momentin e sulmit shumë persona ishin në atë rrugë. Një grua, që ishte në një dyqan në rrugën Istiklal, tha se pas shpërthimit kishte kaos. "Kam parë njerëz të plagosur që rrokulliseshin në rrugë", tha ajo për BBC. "Njerëzit filluan të vraponin në panik... Ka pasur tym të zi. Zhurma ishte e fortë, pothuajse shurdhuese", tha një tjetër dëshmitar, Cemal Denizci, për agjencinë AFP. Rruga Istiklal, ku ndodhi sulmi, edhe më herët kishte qenë cak i sulmeve vetëvrasëse me bomba më 2016. Sipas agjencisë shtetërore të lajmeve "Anadolu", pesë

prokurorë janë caktuar që ta hetojnë këtë ngjarje. Zona ku ndodhi shpërthimi është evakuuar. Pas shpërthimit në Stamboll, Ambasada e Kosovës në Ankara ka vënë në dispozicion një numër kontaktues emergjent të Konsullatës në Stamboll për qytetarët e Kosovës që gjenden në shtetin turk. "Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës në Turqi janë në komunikim të ngushtë me autoritetet vendore turke lidhur

me zhvillimet e fundit", thuhet në njoftim. Ndërkaq, vëzhguesi i medieve në Turqi ka ndaluar përkohësisht raportimet e medieve për shpërthimin, që do të thotë se transmetuesit nuk mund të shfaqin video të momentit të shpërthimit apo edhe të momenteve pasuese. Bordi Suprem i Radios dhe Televizionit kishte vendosur ndalesa të tilla edhe në të kaluarën pas sulmeve apo edhe për disa çështje politike.

Turqia ishte goditur nga një seri bombardimesh vdekjeprurëse edhe më 2015 dhe 2017, përgjegjësinë e të cilave e kishin marrë grupi militant Shteti Islamik dhe militantët kurdë. Nga ato sulme janë vrarë mbi 500 civilë dhe personel i sigurisë. Turqia për një kohë të gjatë lufton kundër militantëve kurdë - apo Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit, që njihet si organizatë terroriste nga Turqia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.



Propozimi i ri për liberalizimin hyn në fuqi jo më vonë se në dhjetor 2023



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Presidenca çeke e Bashkimit Evropian ka hartuar një vendim të ri për liberalizimin e vizave për Kosovën, ku thuhet se nisja e zbatimit të liberalizimit të vizave do të ndodhë në të njëjtën kohë me atë të sistemit ETIAS, por jo më vonë se 1 dhjetori i vitit 2023. Vendimi i ri, në të cilin ka pasur qasje "Radio Evropa e Lirë", është formalizuar pas takimit të përfaqësuesve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në grupin punues për vizat në Këshillin e BE-së, takim që u mbajt të enjten.

Ky propozim është një kompromis mes kërkesës së Francës që hyrja në fuqi të lidhet me funksionalizimin e Sistemit Evropian të Informimit dhe Autorizimit të Udhëtimit (ETIAS), edhe pse shumica e shteteve anëtare kanë kërkuar që këto dy tema të mos lidhen, ose së paku të ketë një datë të prerë se kur qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në zonën Shengen. "Heqja e vizave do të vlejë vetëm për bartësit e pasaportave biometrike të lëshuara në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil [ICAO] dhe nuk do të zbatohet deri në nisjen efektive të operimit të ETIAS, por në çdo rast jo më vonë se 1 dhjetori i vitit 2023", thuhet në draftin e fundit të tekstit të propozimit nga

Presidenca çeke dhe Këshilli i BE-së sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën.

Sipas diplomatëve të BE-së, kjo do të thotë se liberalizimi mund të nisë më 1 nëntor 2023 në rast se në atë datë nis edhe funksionimi i ETIAS-it. Por, nëse ky sistem nuk do të jetë i gatshëm apo nuk do të nisë që të zbatohet, atëherë liberalizimi i vizave gjithsesi do të nisë më së voni më 1 dhjetor të vitit 2023.

Diplomatët e BE-së e konsiderojnë këtë gjë si të rëndësishme për Kosovën pasi në këtë mënyrë, sipas tyre, shmanget mundësia që Kosova të presë për liberalizim në rast të moshyrjes në fuqi të ETIAS-it. Funksionalizimi i këtij sistemi është shtyrë disa herë edhe pse ai teknikisht ka qenë gati. Afati i ri i nisjes së zbatimit të ETIAS-it është 1 nëntori i vitit 2023, por nuk ka garanci se kjo në të vërtetë do të ndodhë.

Tani propozimi çek është në të ashtuquajturën "procedurë të heshtur" në grupin punues për vizat në Këshillin e BE-së. Nëse asnjë vend nuk do të ketë vërejtje deri më 16 nëntor, atëherë vendimi do të kalojë për miratim në nivel më të lartë, atë të ambasadorëve të shteteve anëtare në trupin e quajtur Coreper. Në këtë trup çështja e vizave mund të vihet në rend dite më 23 nëntor. Nëse kalon në këtë trup, atëherë çështja mund të

dërgohet për negociata në Parlamentin Evropian.

Synimi është që deri në fund të vitit të merret një vendim për liberalizimin e vizave dhe të caktohet data e hyrjes në fuqi së bashku me ETIAS-in, apo më së voni deri më 1 dhjetor të vitit 2023.

Liberalizimi i vizave në këtë rast do të paraqitet si një prej sukseseve më të mëdha të BE-së në raport me zgjerimin dhe me rajonin e Ballkanit Perëndimor, dhe kjo çështje mund të përfshihet edhe në deklaratën e përbashkët që do të mund të miratohet në samitin BE-Ballkani Perëndimor që do të mbahet më 6 dhjetor në Tiranë të Shqipërisë.

Në propozimin e fundit të Presidencës çeke kanë mbetur edhe kërkesat ndaj Kosovës që deri në nisjen e liberalizimit të vizave, të përshtatë politikat e vizave me ato të BE-së dhe të bëjë marrëveshje apo aranzhime për riatdhesim me ato shtete të BE-së me të cilat nuk ka marrëveshje të tilla. "Pa paragjykuar qëndrimet e shteteve anëtare ndaj statusit të Kosovës, në periudhën deri në nisjen efektive të liberalizimit të vizave dhe ku është e vlefshme, Kosova duhet të synojë t'i përmbysë marrëveshjet apo aranzhimet për riatdhesim me shtetet anëtare me të cilat ende nuk ka marrëveshje të tilla dhe t'i

përmbushë obligimet e saj nga këto marrëveshje apo aranzhime", thuhet në propozim.

Në versionin e mëhershëm ishin përmendur vetëm "marrëveshjet", por tani në tekst është futur edhe termi "aranzhime". Kjo është bërë që Kosova dhe shtetet që nuk njohin pavarësinë e saj të mund të bëjnë "aranzhime" për këtë çështje, nëse këto shtete nuk duan të arrijnë marrëveshje formale ndërshtetërore.

Në tekst thuhet, po ashtu, se Kosova ka bërë përparim domethënës në të gjitha blloqet e udhërrëfyesit për vizat, sikurse sigurinë e dokumenteve, menaxhimin e kufijve dhe migrimit, përfshirë edhe azilin, rendin publik dhe sigurinë, si dhe në çështjen e të drejtave themelore që lidhen me lirinë e lëvizjes. "Për ta siguruar menaxhimin e mirë të migrationit dhe sigurisë, Kosova duhet të synojë që ta përshtatë më tutje politikën e saj të vizave me atë të Bashkimit Evropian", thuhet në dokument.

Vendet anëtare të BE-së në takimin e fundit të grupit punues për vizat kishin përafëruar qëndrimet rreth një kompromisi por, siç kishte komunikuar Presidenca çeke, nuk kishin arritur konsensus.

Në grupin punues për vizat ishin zhvilluar dy diskutime për

çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Diskutimi i parë ishte zhvilluar më 13 tetor dhe atëherë shumica e madhe e vendeve kishin mbështetur liberalizimin e vizave, asnjë nuk ishte shprehur kundër, por Franca kishte kërkuar që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave të lidhet me hyrjen në fuqi të ETIAS-it.

Diskutimi i dytë në të njëjtin grup punues ishte mbajtur më 10 nëntor. Në këtë diskutim, sipas burimeve të BE-së, të gjitha vendet kishin shprehur interesim që të mos ketë vonesa në miratimin e vendimit për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Tani besohet se kompromisi për të cilin kanë rënë dakord në takimin e fundit do të mundësojë që vendimi të miratohet sa më shpejt, megjithëse hyrja e tij në fuqi do të caktohet për datën 1 nëntor të vitit 2023 bashkë me sistemin ETIAS, apo në çdo rast më 1 dhjetor. Por, gjithmonë ekziston mundësia që ndonjë shtet të ketë vërejtje dhe të shtyhet përsëri miratimi i vendimit.

Më 2018 Komisioni Evropian ka konfirmuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet e kërkuara për lëvizjen e lirë, por disa udhëheqës individualë të bllokut kanë shprehur vazhdimisht rezerva për lëvizjen e lirë të kosovarëve.

Krasniqi javën e ardhshme në Uashington dhe Bruksel

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka njoftuar se do të udhëtojë për vizitë zyrtare në Uashington e

Bruksel. Ai gjatë javës së ardhshme do të ketë takime me zyrtarë të lartë amerikanë dhe evropianë. Lideri i opozitës ka thënë se situata aktuale, sfidat dhe

rrugët tona përpara, do të jenë tema të diskutimeve në dy kryeqendrat e globit. "Kohët e vështira kërkojnë bashkëpunim me partnerët e vërtetë, të besueshëm dhe

strategjikë. Me miq të cilët ia duan të mirën Kosovës, popullit tonë dhe që mbajnë gjithmonë dyert hapur për ne", shkroi Krasniqi në "Facebook".



Instituti GAP kërkon miratimin e pagës së re minimale dhe heqjen e tatimit për gazin e peletin

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Instituti për Studime të Avancuara GAP ka thënë se rritja e ndjeshme e çmimeve po e rëndon mirëqenien e familjeve në Kosovë, derisa sfidues do të jetë edhe furnizimi me energji elektrike në muajt në vijim. GAP me anë të një raporti ka kërkuar miratimin e Ligjit të ri të Pagës Minimale dhe heqjen e tatimit për gazin dhe peletin. "Krahas masave aktuale të qeverisë, është e duhur që të miratohet paga e re minimale e cila do të ndikonte në rreth 106 mijë punonjës të sektorit privat.

Po ashtu, ta konsiderojë lirim nga obligimet tatimore për gazin dhe peletin, çmimet e të cilave parashihet të kontrollohen përmes ligjit të ri", ka theksuar GAP në raportin "Si ndikon në inflacionin kontrolli i çmimeve të produkteve?". Po ashtu, aty thuhet se nëse problemi me inflacionin shndërrohet në problem afatgjatë, politika e kontrollit të çmimeve mund t'i dëmtojë sektorët e ndikuar. "Nëse problemi me inflacionin shndërrohet në problem afatgjatë, politika e kontrollit të çmimeve mund t'i dëmtojë sektorët e ndikuar, siç tregojnë gjetjet nga vendet e tjera të cilat



kanë aplikuar masa të ngjashme. Me Ligjin e miratuar nga Kuvendi do të preken sektorë që së bashku kanë qarkulluar mbi 1.1 miliard euro në vitin 2021

apo sa 15 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto për atë vit. Praktikrat e vendeve të tjera tregojnë që kontrolli i çmimeve si instrument për uljen e

inflacionit është joefektiv, meqë pas heqjes së kufizimeve çmimet kanë tendencë të rriten menjëherë", thuhet në raport, duke theksuar se aplikimi i formave të tjera të ndihmës ndaj qytetarëve, që kryesisht parashohin uljen e normave tatimore ose heqjen e TVSh-së dhe akcizës për disa produkte, mund të ketë ndikim buxhetor nga 205 deri 246 milionë euro në gjashtë muaj apo rreth 455 milionë euro në vit. "Ndër problemet kryesore me politika të tilla mbetet targetimi joadekuat si dhe ndikimi në rritjen artificiale të konsumit", përfundon raporti i GAP-it.

Në Paris, Kurti diskuton për çështje energjetike dhe mjedisore me AFD-në



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, takoi Cyril Bellier, drejtor për Evropën Lindore, Lindjen e Mesme dhe Azinë, në Agjencinë Franceze për Zhvillim - AFD (Agence Française de Développement) dhe Vladimir Deliry, nga Ministria për Evropë dhe Punë të Jashtme të Francës. Sipas qeverisë, duke biseduar për angazhimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillimin socio-ekonomik të vendit, kryeministri Kurti theksoi se Kosova është qendër e rajonit të EMENA-s dhe, krahas pozitës gjeografike dhe stabilitetit institucional, Kosova ka potencial të madh në rajon. "Në takim u bisedua edhe për sfidat sociale dhe ekonomike që janë specifike për Kosovën, duke përfshirë çështjet

energjetike dhe mjedisore. Bellier foli për objektivat e AFD-së në rajon dhe për veprime të mëtejshme për adresimin e sfidave specifike të Kosovës. U bisedua për angazhimin e Agjencisë Franceze për Zhvillim në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe përpjekjet e përbashkëta drejt arritjes së Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në veçanti u bisedua për aktivitetet që janë pjesë e Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor kushtuar investimeve strategjike socio-ekonomike në rajon në koordinim me objektivat e Bashkimit Evropian për integrimin e rajonit", thuhet në komunikatë. Takimi në Paris i paraprin një vizite të rëndësishme të AFD-së në Kosovë javën e ardhshme.

Adem Salihaj largohet nga politika

FERIZAJ, 13 NËNTOR - Ish-kryetari i Ferizajt, njëherësh kryetar i Degës së LDK-së në këtë komunë, Adem Salihaj, ka njoftuar se ka dhënë dorëheqje nga ky subjekt politik dhe është larguar përfundimisht nga politika.

Salihaj në "Facebook" ka shkruar se 18 vjet ka qenë në krye të LDK-së në Ferizaj. "Të dashur veprimtarë, sot kemi ardhur në një moment kur unë dua ta përfundoj periudhën e angazhimit partiak dhe të marrin

përgjegjësi gjeneratat e reja, ta vazhdojnë punën dhe aktivitetin në LDK. Shpresoj se do të gjenden njerëz që do ta vazhdojnë vizionin rugovian dhe frymën e lirisë, pavarësisë dhe demokracisë, tri shtyllat

kryesore dhe tri vlerat më të mëdha të partisë sonë, të vendosura nga Presidenti Rugova. Unë dëshiroj që tash e tutje t'i përkushtohem familjes dhe shkrimeve", thuhet në shkrimin e tij.



“Super-taksë” për fermerët shqiptarë që lënë tokën djerrë



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Maringlen Avdoli, një fermer nga fshati Vashthi i Korçës - pjesa juglindore e Shqipërisë - prej vitesh mbjell me perime gjithë sipërfaqen e tokës që zotëron - rreth 15 dynmë. Sivjet thotë se ka vendosur ta lërë djerrë, sepse puna nuk i shpaguhet. “Janë shtrenjtuar plehrat kimike, është rritur çmimi për plugimet, frezimet... farat janë rritur për 30 % e më shumë. Përse ta punoj? Të më ikë gjithë munda kot?”, shprehet 38-vjeçari për “Radion Evropa e Lirë”.

Për më tepër, shton ai, edhe grumbulluesit e marrin me një çmim shumë të lirë prodhimin e tij, ashtu si edhe të fermerëve të tjerë.

Si gjatë në botë, inflacioni në Shqipëri është në rritje - aktualisht mbi 8 për qind - dhe çmimet e gati të gjitha produkteve janë shtrenjtuar. Maringleni, baba i dy fëmijëve, thotë se tash e tutje do të punojë vetëm aq sa i nevojitet për familjen e tij. Ai nuk është i vetmi fermer që ka vendosur ta lërë djerrë tokën.

Të dhënat e fundit të Institutit të

Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) tregojnë se rreth 30 % e tokës bujqësore në këtë vend nuk punohet.

Nga rreth 2 milionë e 875 mijë hektarë tokë sa ka Shqipëria, 699 mijë hektarë janë tokë bujqësore.

Nga qeveria e vendit kanë paralajmëruar se lenia e tokës djerrë nuk do të kalojë pa u ndëshkuar. “Do të ketë super-taksim të tokës [së lënë] djerrë”, ka thënë kryeministri Edi Rama, por pa specifikuar se sa do të jetë ajo taksë. “U kam kërkuar deputetëve të ulen bashkë me ju [fermerët] dhe të punojnë me Ministrinë e Financave, për të vënë një normë ligjore, që kush nuk e punon tokën, nuk mund ta lërë atë djerrë, të rrijë rehat dhe të thotë: s’ta jap me qira, s’ia jap kujt ta punojë...”, ka thënë Rama në takimet që ka zhvilluar gjatë këtij muaji me fermerë në Fier dhe Korçë.

Aktualisht taksa e tokës bujqësore në Shqipëri varion nga 1.800 lekë (15 euro) për hektar në vit deri në 5.600 lekë, varësisht kategorisë, e cila klasifikohet nga Ministria e Bujqësisë.

“I falimentuar edhe nëse e punoj, edhe nëse nuk e punoj tokën”

Fermeri nga fshati Vashthi në Korçë thotë se nuk është aspak dakord me qasjen e paralajmëruar të qeverisë. “Unë jam i falimentuar edhe nëse e punoj, edhe nëse nuk e punoj tokën”, thotë ai. “Provova ta punoj dhe vetëm sa u sflitëm e gjithë familja, asgjë nuk fituam. Tani që e lë pa mbjellë, dashkan të na taksojnë, të na gjobisin. Keq këtej, keq andej”, thotë Maringleni.

“Super-taksa” nuk është zgjidhje as për Ervin Resulin, udhëheqës i Shoqatës së Fermerëve në Shqipëri. Sipas tij, zgjidhja do të ishte te “stimulimi [i fermerëve] me skema mbështetëse”.

Ekspertë të kësaj fushe pajtohen se duhet zgjidhur urgjentisht problemi i tokës së lënë djerrë, po ashtu thonë se zgjidhja nuk duhet të rëndojë mbi fermerët. “... përkundrazi, [fermerët] duhen ndihmuar dhe stimuluar që të mos e lënë tokën djerrë. Çdo nismë ligjore duhet të

ndërmerret në konsultë edhe me fermerët, edhe me ekspertë të fushës”, thotë për “Radion Evropa e Lirë”, Agim Rrapaj, udhëheqës i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar.

Sipas ekspertit të bujqësisë, Ilir Pilku, plani i Ramës, përveçse nuk është zgjidhje, ka edhe probleme juridike. “Vendosja e një ligji të tillë për taksim të rëndë për fermerët që nuk e punojnë dot tokën ose nuk e japin me qira ka një problem juridik. Nëse kanë paguar detyrimin për taksën bujqësore... si do t’i taksosh? Por, edhe për ato familje fermerësh që nuk e paguajnë taksën e tokës, apo për ata që janë në emigracion, duhet lënë një kohë për marrjen e vendimit”, thotë Pilku.

Ai shton se në vend të taksave të mëdha për fermerët, duhen shikuar mundësitë për punimin e tokës. “Unë do ta vija theksin te rritja e prodhimtarisë në Shqipëri, për t’i bërë produktet tona më të konkurrueshme. Duhet parë me interes edhe toka e pashpërndarë, që është tokë apo pyll në inventarin e

Ministrisë së Bujqësisë. T’u jepet prioritet të rinjve që të mos ikin, por t’u jepet kjo sipërfaqe e pandarë”, thotë Pilku. “Të aplikohet nisma ‘Shqipëria 1 euro’ për të rinjtë, që ta marrin tokën [për 1 euro] dhe të zhvillojnë një aktivitet”, shton ai, duke iu referuar një nisme të shpalosur vite më parë, me qëllim nxitjen e rritjes ekonomike.

Fermerët e zonave të ndryshme në Shqipëri kanë dalë shpesh në protesta dhe kanë hedhur në rrugë prodhimet e tyre, duke thënë se nuk u sigurohet treg i mjaftueshëm dhe se subvencionet e qeverisë janë të pamjaftueshme.

Sa ndihmohen fermerët?

Në takimet e ditëve të fundit me fermerë, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se bujqësia këtë vit është mbështetur me fondin më të lartë ndonjëherë - gati 50 milionë dollarë. Ai, po ashtu, ka thënë se fermerëve u janë dhënë 8 milionë litra naftë pa taksa.

Programet e qeverisë shqiptare për fermerë janë: skema kombëtare, skema për naftën dhe skema e njohur si IPARD. Këto skema përfshijnë mbështetje financiare për fara dhe fidanë me 200 000 lekë për hektar, mbështetje për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën e 60 000 lekëve për hektar e të tjera.

IPARD, në anën tjetër, mundëson përfitimim e fondeve për zhvillim të fermave apo agrobizneseve, si dhe për tregtimin apo përpunimin e produkteve bujqësore.

Sipas Organizatës së Ushqimit në Kombet e Bashkuara (FAO), fermerët shqiptarë marrin mbështetje direkte vetëm 3 euro për hektar, ndërsa 42 euro shkojnë për institucionet dhe entet që monitorojnë bujqësinë. Sipas raportit të kësaj organizate, të publikuar në qershor të këtij viti, në vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, pjesa më e madhe e fondeve shkojnë për fermerët.

Ministrat e G20-s, fond miliardësh për pandeminë

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ministrat e Shëndetësisë dhe Financave të G20-s kanë iniciuar një fond prej 1.4 miliardë dollarësh për t’u përballur me pandeminë e ardhshme globale para se liderët e këtij grupi të mblidhen në samitin në Bali të Indonezisë. Megjithatë, presidenti i Indonezisë tha se ky fond nuk është i mjaftueshëm.

Fondi i krijuar nga 24 shtete po shihet si një prej rezultateve të hershme të samitit ku pritjet të

arrihet përparim në samitin e javës së ardhshme për krizën në Ukrainë. Në samitin në Bali nuk do të marrë pjesë presidenti rus Vladimir Putin.

Gjatë konferencës për medie të dielën u iniciua ky fond nga presidenti i Indonezisë, Joko Widodo. Në këtë konferencë të pranishëm ishin edhe shefi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Adhanom Ghebreyesus, dhe presidenti i Bankës Botërore, David Malpass.

“G20 pajtohet të krijojë një fond për pandeminë për të parandaluar dhe për t’u përgatitur për pandeminë. Donatorët e G20-s dhe shtetet joanëtare të këtij grupi, por edhe organizatat filantropike kanë kontribuar në këtë fond. Por, ky fond nuk është i mjaftueshëm”, tha Widodo.

Ai tha se kërkohen 31 miliardë dollarë për t’u përballur me pandeminë e ardhshme globale. “Ne duhet t’i sigurojmë komunitetet në pandemi.



Pandemia më nuk duhet të marrë jetë njerëzish dhe ta shkatërrojë ekonominë globale”, tha presidenti i Indonezisë.

Shtetet e Bashkuara kanë kontribuar me 450 milionë dollarë në këtë fond, apo pothuajse një të tretën e totalit të shumës.

Murali i Banksyt, në ndërtesën e granatuar nga Rusia në Ukrainë



Artisti i njohur i grafitëve, Banksy, ka zbuluar veprën e tij të fundit, të realizuar në një ndërtesë të shkatërruar nga granatimet ruse në Ukrainë, raporton BBC, transmeton Telegrafi.

Banksy postoi një foto në Instagram, të kësaj vepre: një gjimnaste duke qëndruar në duar, mbi rrënojat në Borodianka.

Muralet brenda dhe rreth kryeqytetit të Ukrainës, Kievit, nxitën spekulimet se artisti anonim po punon në vendin e shkatërruar nga lufta.

Në një vepër tjetër, që ende nuk është pranuar zyrtarisht, përshkruhet një burrë që i ngjan

Vladimir Putin, duke u mundur në xhudo nga një fëmijë.

Artisti i grafitëve postoi tri imazhe të muralit të gjimnastes, në rrënojat e lëna nga granatimet ruse, me mbishkrim që thjesht thoshte: “Borodianka, Ukrainë”.

Borodianka ishte një nga vendet më të goditura nga bombardimet ruse në Ukrainë, menjëherë pas pushtimit të 24 shkurtit.

Ushtarët rusë pushtuan qytetin – i vendosur rreth 30 milje (48 kilometra) në veriperëndim të kryeqytetit të Ukrainës, Kievit – për javë të tëra në fazën fillestare të luftës, përpara se të çlirohej përfundimisht, në prill, nga

Ukraina.

Vepra e dytë në Borodianka, që nuk është konfirmuar se është nga Banksy, përshkruan një burrë që i ngjan Vladimir Putin, duke u rrokullisur gjatë një ndeshjeje të xhudos me një djalë të ri. Presidenti rus ka rrip të zi xhudo dhe është admirues i njohur i këtij arti marcial.

Pasi qyteti është rimarrë, redaktori ndërkombëtar i BBC News, Jeremy Bowen – korrespondent veteran i luftës – tha se shkatërimi i kryer nga granatimet ruse në Borodianka, ishte më i keqi që kishte parë në Ukrainë në atë kohë. Disa dëshmitarë thanë se trupat

ruse ndaluan përpjekjet për të nxjerrë të mbijetuarit nga ndërtesat e shkatërruara, duke kërcënuar me armë njerëzit që donin ta bënin këtë.

BBC News ka dëgjuar gjithashtu historinë e një oficeri të policisë lokale që humbi gjashhtë anëtarë të familjes – nënën, babanë, vëllain, gjyshen, gruan dhe vajzën njëvjeçare – në një sulm të vetëm rus.

Vepra e tretë e artistit, që duket se është pikturuar nga Banksy, tregon një gjimnaste ritmike, që mban zinxhirët në qafë, duke performuar me fjongo në majë të një vrime të hapur në njërin anë të një

ndërtese në Irpin.

Qyteti që është në periferi të Kievit, ishte vendi i një masakre famëkeqe të qindra civilëve të vrarë nga trupat pushtuese ruse.

Banksy është një nga artistët më të famshëm në botë – ndërkohë që mbetet plotësisht anonim.

U bë i famshëm me në Bristol në fillim të viteve 1990. Por, me kalimin e viteve, shembujt e punës së tij janë shfaqur në Paris, Nju-Jork dhe Park Siti, në Juta

Shpeshherë i përshkruar si “i pakapshëm” dhe “i fshehtë” nga shtypi, “artisti gueril i rugës” ka një legjion adhuruesish që përfshin edhe të famshëm të listës A.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82


Derbi i takon Gjilanit, fitojnë edhe Drita e Ballkani

Derbin e xhiros në elitë e ka fituar Gjilani në përballje me skuadrën e Llapit, derisa golin e fitores e ka shënuar Solomon. Fitoreve kanë realizuar edhe Drita dhe Ballkani në përballje me Malishevën, përkatësisht Ferizaj

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

GJILAN, 13 NËNTOR - Tri ndeshje të javës së 17-të në Superligën e Kosovës në futboll janë zhvilluar të dielën. Gjilani ka shënuar fitore të madhe në ndeshjen derbi ndaj Llapit me rezultat 1-0. Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi pa gola, kurse pesë minuta pasi filloi pjesa e dytë "Skifterat" kaluan në epërsi me golin e shënuar nga Theopilus Solomon. Pas tri pikëve të reja, Gjilani është në vendin e tretë me 27 pikë, kurse në anën tjetër

Llapi zë pozitën e shtatë me 19 pikë. Edhe skuadra tjetër nga qyteti i Gjilanit, Drita ka shënuar fitore në këtë xhiro. Kryesuesit e elitës e kanë mposhtur Malishevën me rezultat 3-1. Golin e parë në ndeshje e ka shënuar Besnik Krasniqi, në minutën e 45', me këtë rezultat përfundoi pjesa e parë. Në pjesën e dytë, Malisheva e barazoi rezultatin me Drilo Hazrollaj, derisa Ilir Blakçori, shënoi golin e dytë për Dritën, në minutën e 60-të. Shtatë minuta pa përfunduar ndeshja, Ardit Tahiri realizoi golin e tretë



dhe të fundit në ndeshje. Drita pas fitores mbetet në vendin e parë me 35 pikë, derisa Malisheva renditet në pozitën e tetë me 18 pikë. Kampionia në fuqi, Ballkani ka shënuar fitore të lehtë ndaj Ferizajt, me rezultat 2-0. Golin e parë në ndeshje e ka

shënuar Armend Thaqi në minutën e 65-të, derisa golin e dytë Albion Rrahmani. Ballkani mbetet në vendin e dytë me 30 pikë, derisa Ferizaj është në vendin e fundit me 12 pikë. Të shtunën Prishtina pësoi humbje nga Drenica në kryeqytet me

SUPERLIGA - JAVA 17

Llapi-Gjilani	0-1
Drita-Malisheva	3-1
Ballkani-Ferizaj	2-0
Prishtina-Drenica	0-1
Dukagjini-Trepça '89	1-0

Tabela		Pikë
1. Drita	17	35
2. Ballkani	14	30
3. Gjilani	17	27
4. Prishtina	16	23
5. Dukagjini	17	21
6. Drenica	17	20
7. Llapi	16	19
8. Malisheva	17	18
9. Trepça '89	16	18
10. Ferizaj	17	12

rezultat 0-1, derisa Dukagjini e mposhti me rezultat të njejtë Trepçën '89.

Bashkimi e fiton dramën në Prizren, Prishtina triumfon në Gjakovë

PRIZREN, 13 NËNTOR - Në një ndeshje shumë interesante dhe dramatike, Bashkimi ka mundur rivalin lokal, Ponte Prizrenin me shifrat 80:81 (21:23, 23:21, 27:23, 9:14), në xhiron e dhjetë të Prince Caffè Superligës së Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte tërësisht i barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte shkëputjen dhe përfundon 21:23. Lojë e ngjashme u zhvillua edhe në periudhën e dytë, ku epërsinë më të lartë e kishin vendasit, por vetëm deri në shtatë pikë, 41:34, por më pas u këndellen Portokallezinjtë, derisa pjesa e parë përfundoi 44:44. Loja interesante në Prizren vazhdoi edhe në pjesën e dytë, përkatësisht periodën e tretë, që ishte me shumë rikthime, e



ku herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 71:67. Dramë u zhvillua deri në fund, ku Ponte ishte duke udhëhequr 77:74, por shtatë pikë radhazi nga mysafirët ishin vendimtare,

ndërsa basketbollistët e Ponte Prizrenit synuan rikthimin në fund, por nuk ndodhi dhe Bashkimi triumfoi 80:81. Te Ponte Prizreni u dalluan Wayne Arnold me 17 pikë dhe Ivan Koljeviq me 16, kurse te Bashkimi më të mirët ishin

Faho Alihoxhiq me 19 pikë e tetë kërcime dhe Prentiss Nixon me 17 pikë e tri kërcime. Ponte Prizreni ka katër fitore e pesë humbje, kurse Bashkimi ka katër fitore e gjashtë humbje. Sigal Prishtina shënoi fitore të rëndësishme, duke mundur Vëllaznimin në udhëtim 71:79 (14:22, 18:22, 21:11, 18:24), në xhiron e dhjetë të Prince Caffè Superligës. Fillimi i ndeshjes i barabartë, por në 2-3 minutat e fundit të çerekut të parë, prishtinasit u shkëputën për të fituar këtë pjesë 14:22. Kryeqytetasit vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, ku e ngritën epërsinë në 17 pikë, 19:36, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 32:44. Kuqezinjtë të përkrahur nga tifozët vendas nuk u dorëzuan

dhe arritën përmbysjen e madhe për të barazuar shifrat në 46:46 dhe kaluan në epërsi 53:52, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 53:55. Megjithatë, në dhjetë minutat e fundit dhe vendimtarë, basketbollistët prishtinas ishin më të vëmendshëm, duke fituar në fund 71:79. Të Vëllaznimit u dalluan Damonte Dodd me 10 pikë e 11 kërcime dhe Emmanuel Omogbo me 17 pikë, kurse te Sigal Prishtinas u dalluan Derrick Wilson me 19 pikë, tetë kërcime e gjashtë asistime dhe Dustin Thomas me 19 pikë e shtatë kërcime. Kuqezinjtë kanë katër fitore e gjashtë humbje, kurse prishtinasit gjashtë fitore e katër humbje.

Krasniqi publikon listën e Kosovës U19 për ndeshjet kualifikuese në Suedi

Prishtinë, 13 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës U19 nga 15 nëntori deri më 23 nëntor do të qëndrojë në Suedi, ku do t'i zhvillojë ndeshjet e fazës 'Main Round' për kualifikimet e Kampionatit Evropian. "Dardanët" bëjnë pjesë në Grupin 3, ku janë edhe Ukraina, Qipro dhe Suedia, si nikoqire e turneut kualifikues. Djelmoshat e drejtuar nga Ramiz Krasniqi janë grumbulluar të shtunën dhe janë duke u stërvitur në Kampin

Nacional në Hajvali, teksa më 15 nëntor do të marrin rrugë për në shtetin skandinav. Ndeshjen e parë, Kosova U19 do ta luajë kundër Ukrainës, më 17 nëntor, në orën 13:00 në "Nya Parken Stadium" në Norrköping. Më pas, më 20 nëntor, në të njëjtin stadium, Dardanët do të ballafaqohen me Suedinë, në orën 18:30, derisa ndeshjen e fundit e luajnë kundër Qipros, më 23 nëntor, në orën 18:00 në "Linköping Arena Stadium" në Linköping.

Lista e futbollistëve

Altin Gjokaj, Laurence Shala, Gent Rexhepi, Drin Miftari, Dijon Ajvazi, Ledjan Sahitaj, Eridon Maloku, Altin Mehaj, Riad Jashari, Milot Ajeti, Blerjon Avdimetaj, Iqball Jashari, Etnik Brruti, Rion Selimi, Arjanit Hasani, Arjol Bllaca, Arlind Maloku, Andi Kadriu, Drilon Hazrollaj, Ermir Rashica.





Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Trepça Shoqëri Aksionare
 Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 11.11.2022 bënë shpallje publike:

NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-22-07

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e zyrave ne Terminalin doganore dhe depos në Industrinë baterive.
 Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë
 Numri i ofertave të pranuar: 20(njëzet)

ME KONTRATË SHPËRBLEHET

- Loti 1 Zyre 10 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – NANI Impex
- Loti 2 Zyre 11 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – ServisShped
- Loti 3 Zyre 12 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – MonDi Shped
- Loti 4 Zyre 13 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Auto Shped
- Loti 5 Zyre 14 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Rahova Shped
- Loti 6 Zyre 15 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Fitimi Shped
- Loti 6 Zyre 15 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Eni Shped
- Loti 7 Zyre 16 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – IDEAL SHPED
- Loti 9 Zyre 18 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Germova 2
- Loti 10 Zyre 19 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – GIMA1
- Loti 11 Zyre 20 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – BKS
- Loti 12 Zyre 21 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Proka
- Loti 13 Zyre 22 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – ARS SHPED
- Loti 14 Zyre 23 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Flonja
- Loti 14 Zyre 23 (1/2) çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – A shped
- Loti 15 Zyre 24 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Real Shped
- Loti 16 Zyre 25 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Alpha shped
- Loti 17 Zyre 26 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – Asllan & Sons
- Loti 18 Zyre 27 çmimi për m² 11.00 € pa TVSH – BOBI FLJ
- Loti 21 – depos në Industrinë baterive çmimi me TVSH 1,500.00 -NTSH -Dega në Kosovë

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 16.11.2022 ora 10:00

NJOFTIM PËR ANULIM : T-22-07

Lot 8, 19 dhe 20 Anulohen për shkak të mos pranimit të asnjë oferte:

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Drejtësisë - Ministraskoo Pravde - Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

**Datë 10.11.2022
 011/2022**

Referenca: AAPSK –

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Rimorkio Traylor S33 EN 14, ngjyre e hirit për skrap	1 copë për skrap	1,300.00€		
2	VW Golf 2, viti i prodhimit 1985, ngjyre e hirit-për skrap	1 copë për skrap	232.00€		
3	VW Golf 2, viti i prodhimit 1989,benzin, ngjyre e kalter -për skrap	1 copë për skrap	232.00€		
4	VW Golf 2, viti i prodhimit 1989,benzin, ngjyre e kalter -për skrap	1 copë për skrap	232.00€		
5	VW Golf 3, ngjyre e gjelber-për skrap	1 copë për skrap	300.00€		
6	Furgon- Mercedes Benz 312, viti i prodhimit 1999,ngjyre e bardhë -për skrap	1 copë për skrap	400.00€		
7	Rimorkio pa targa- për skrap.	1 copë për skrap	200.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 17.11.2022 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 17.11.2022, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se ,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051

Oferte për shitjen e patundshmerise

Zija (Gjimshit) Bilalli nga Dragashi (Brrut) me adres banimi Rr. Meleq Begu nr.23 Prizren i cili eshte bashkepronar ne pjesen prej 1/2 e pjeses ideale te patundshmeris , me numer te Njesis kadastrale P- 71813068 - 02460 -0 ne vendin e quajtur " Partizani " Toke ndertimore 239m2 obor dhe 1.90m2 shtepi - Ndertese , me siperfaqe te pergjithshme prej 429m2 zona Kadastrale Prizren.

Nga pjesa e vet ideale ofron per shitje siperfaqen e pergjithshme prej 214.5 m2 (apo 1/2 e pjeses ideale) te patundshmerise me te dhenat si me lart, ne shumen e pergjithshme prej 250.000 (me shkronja : Dyqinde e Pesedhete Mij euro) , Prizren . 11.11.2022

Ofertuesi :
Zija (Gjimshit) Bilalli

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- D.P.H "ABA" Ilir Tuli B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330279621.

- Mishtore "Meli" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811932038.

- Dr. Azem Spahiu shpall të pavlefshme Licencën e Mjekësisë Familjare të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës me nr. KO-00787-01-21 datë 24.11.2017/ 24.11.2022.

- Dren Ahmeti shpall të pavlefshme diplomën e masterit-it, të FNA-së, Prishtinë.

- Lumturije Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Borë Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M "Selman Riza", nga klasa e -I- deri -VIII-, Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -IX- të SH.M.T "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

